



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË SKRAPAR

Nr. 10 prot.

Çorovodë më: 19.02 2021

NJOFTIM

Lënda: Njoftim për mbajtjen e mbledhjes së Këshillit të Bashkisë Skrapar

I nderuar Këshilltar,

Ju njoftoj se ditën e Enjte më datë 25.02.2021, ora 11⁰⁰, në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Bashkisë Skrapar, Qendra Kulturore "Riza Cerova" Kati i Dytë, zhvillohet mbledhja e radhës e Këshillit të Bashkisë Skrapar, e thirrur nga Kryetare e Këshillit në zbatim të Ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, neni 53, pika 4, me këtë rend dite :

1. Miratimi i rendit të ditës
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 22.01.2021.
3. Deklarimet e konfliktit të interesave.
4. Projektvendim, "Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin Janar 2021".
5. Projektvendim, "Për miratimin e Raportit të vlerësimit dhe parashikimit afatmesem 2022-2024, të të ardhurave për Bashkinë Skrapar dhe institucioneve në varësi të saj".
6. Projektvendim, "Për detajimin në nivel artikulli dhe programi të transfertës pakushtëzuar sektoriale, akorduar për arsimin 9- vjeçar për efekt të rritjes së pagave".
7. Projektvendim, "Për një ndryshime në VKB Nr.68, datë 24.12.2020 "Për miratimin e buxhetit vjetor 2021 dhe të projekt-buxhetit afatmesëm 2021-2023 të Bashkisë Skrapar dhe institucioneve në varësi të saj".
8. Projektvendim, "Për ngritjen e Komisionit Këshillimor për dhënien e Titujve Vendore të Nderit në Bashkinë Skrapar".
9. Të ndryshme.

**KRYETARE KËSHILLIT BASHKIAK
EDLIRA SHKËMBI**